KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Prill 2024

22.05.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin prill 2024.

Deficit tregtar prej 12,2% në muajin prill 2024, krahasuar me muajin prill 2023

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 12,2% në muajin prill 2024, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2023, gjegjësisht në vlerë prej 427,5 milion Euro, krahasuar me deficitin prej 381,0 milion Euro në vitin 2023. Eksporti mbulon importin me 14,6%.

Eksporti i mallrave në muajin prill 2024 kishte vlerën 73,2 milion Euro, ndërsa importi 500,7 milion Euro, që është një rritje prej 8,8% për eksport, si dhe një rritje prej 11,7% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Qarkullimi e mallrave në tregtinë e jashtme



Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 25,2% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 14,7% e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10,8% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,5% e përbëjnë artikuj të ndryshëm të prodhuar; 8.7% e përbëjnë tekstili dhe artikujt e tekstilit; 5.3% e përbëjnë produktet minerale; etj.

Eksportet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Ndërsa, sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 13,6% e përbëjnë produktet minerale; 11,5% e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 11,3% e përbëjnë mjetet e transportit; 11,2% e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9,6% e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; etj.

Importet sipas sektorëve të grupeve kryesore në vlerë



Eksportet dhe importet sipas vendeve në vlerë dhe %

(në mijë Euro)

Vendet	Prill - 2023		Prill - 2024	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	**67 299**	**100,0**	**73 199**	**100,0**
27 vendet e BE_së	19 532	29,0	24 977	34,1
Cefta	27 003	40,1	32 592	44,5
Të tjera	20 764	30,9	15 630	21,4
	Importet (CIF)			
Gjithsej	**448 259**	**100,0**	**500 728**	**100,0**
27 vendet e BE_së	199 545	44,5	243 399	48,6
Cefta	78 345	17,5	65 460	13,1
Të tjera	170 369	38,0	191 869	38,3

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 25,0 milion Euro, ose rreth 34,1% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 27,9%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (11,4%), Italia (5,0%), Holanda (2,4%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 243,4 milion Euro, ose 48,6% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 22,2%. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (13,9%), Italia (6,9%), Greqia (6,0%), etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 32,6 milion Euro, ose 44,5% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 20.7%. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Maqedonia e Veriut (16,6%), Shqipëria (16,0%), Serbia (5,4%), Mali i Zi (4,8%).

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 65,5 milion Euro, ose 13,1% të importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-16,4%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (5,3%), Maqedonia e Veriut (4,6%), Serbia (1,8%).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 15,6 milion Euro, ose 21,4%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (8,4%) dhe SHBA (3,7%).

Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 191,1 milion Euro, ose 38,3%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (13,5%) dhe Kina (12,6%).

Për më shumë informata, lidhur me Statistikat e Tregtisë së Jashtme për muajin prill 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/ForeignTrade